


PYETËSOR

SHQIPËRIA DHE BE
ÇFARË DUHET TË PRESIN TË RINJTË?





Në një kohë kur tema e Forcës së të Rinjve ka qenë ajo që ka përshkuar pjesën dërrmuese të aktiviteteve të delegacionit të BE në Shqipëri, gjatë viteve të fundit, projekti Bashkitë për në Evropë pati për qëllim që, nëpërmjet këtij anketimi online, të marrë mendimet e të rinjve shqiptarë në të gjithë vendin, mbi *nivelin e informimit të tyre sa u përket çështjeve të Bashkimit Evropian, rolin e BE në Shqipëri, ritmet e integrimit dhe rolet e aktorëve kryesorë, impaktin e projekteve të BE-së në komunitetet ku ata jetojnë, rolin e institucioneve lokale si dhe mundësitë që integrimi i Shqipërisë sjell për jetën e karrierën e tyre.*

Pyetjet u përgatitën nga ekipi i Projektit “**Bashkitë për në Evropë**”, dhe anketimi u publikua online nëpërmjet aplikacionit Facebook Polls.

Të rinjtë e interesuar patën mundësinë të ofrojnë përgjigjet gjatë muajve mars-prill.

Anketimi u publikua në faqen zyrtare të Projektit “Bashkitë për në Evropë”, si dhe në faqet zyrtare të mbi 45 Njësive të Integrimit Evropian në bashkitë e Shqipërisë, me një shtrirje gjeografike domethënëse në të gjithë Shqipërinë.

Pyetjeve të anketimit iu përgjigjën mbi 980 të rinj.



SHQIPËRIA DHE BASHKIMI EVROPIAN

Çfarë duhet të presin të rinjtë? _____

Ky Anketim online u realizua nga “Bashkitë për në Evropë”, një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian.



KONKLUSIONE

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian, mbetet një aspiratë e pandryshueshme për të rinjtë shqiptarë, të cilët e shohin Evropën si destinacionin e vetëm dhe të panegociueshëm për të ardhmen e fëmijëve të tyre.

Në një linjë me sondazhet e fundit të realizuara nga organizata dhe media vendase dhe ndërkombëtare, edhe ky pyetësor online i realizuar nga Projekti “Bashkitë për në Evropë”, konfirmon se shumica dërrmuese e të rinjve (71%), vazhdojnë të jenë të bindur se busulla e shqiptarëve duhet të vazhdojë të tregojë Brukselin si destinacion unik për Shqipërinë.

Një proces ai i integritit evropian për të cilin, tek qytetarët shqiptarë dhe sidomos të rinjtë, është vënë re një shtim i ndërgjegjësimit, kur vjen fjala tek mënyra e funksionimit të Bashkimit Evropian dhe institucionet që e përbëjnë atë. Pavarësisht kësaj, duke patur parasysh që një pjesë e madhe e tyre shprehen se janë vetëm pjesërisht të informuar ndërkohë që 10% janë pak ose aspak të informuar, shpërfaqet qartë nevoja për më shumë fushata informuese dhe sensibilizuese, mbi mënyrën se si funksionon BE dhe atë çfarë pritet nga Shqipëria në marrëdhëniet e saj me Brukselin, në të ardhmen.

Të dhënat e sondazhit të realizuar në muajt prill-maj, tregojnë se pavarësisht se shqiptarët vazhdojnë të besojnë në procesin e integritit, pjesa dërrmuese e tyre (82%) janë të pakënaqur me ritmet me të cilat është duke përparuar ky proces. Sipas tyre, 30 vjet pas ndërrimit të sistemeve dhe 3 dekada nga fillimi i thirrjeve “E duam Shqipërinë si gjithë Evropa”, ecuria e procesit të integritit të Shqipërisë është shumë e ngadaltë dhe pengesat të pajustificuara.

Sërish, shumica prej 74 përqind e të rinjve, e kanë identifikuar faktorin kryesor që ndikon në procesin e integritit të Shqipërisë në BE. Vetëm 13% e tyre ia ngarkojnë këtë peshë vetë Bashkimit Evropian, teksa pjesa dërrmuese mendojnë se politika dhe politikanët kanë një rol vendimtar në këtë proces, dhe vendim-marrja e tyre luan një rol të dorës së parë sa i përket të ardhmes së vendit në familjen e madhe evropiane.

Një e ardhme të cilën, të rinjtë shqiptarë e shohin se do të sjellë më shumë mundësi për ata vetë, si përsa i përket shkollimit, ashtu edhe përsa i përket punësimit.

Në shumicë dërrmuese, të rinjtë mendojnë se përshpejtimi i ritmeve të integritit në Bashkimin Evropian, do të përkthehet në mundësi më të mira arsimimi dhe punësimi për ata vetë dhe bashkëmoshatarët e tyre.

Dhe ndërkohë që shpresat e tyre janë të lidhura fort me integrimin, nga përgjigjet e pyetjeve të sondazhit vihet re një mungesë informacioni mbi mundësitë konkrete që BE ofron sidomos për të rinjtë.

KONKLUZIONE

- ▲ Të rinjtë shqiptarë e shohin veten gjithmonë e më të barabartë me bashkëmoshatarët e tyre në vendet anëtare të Bashkimit Evropian
- ▲ Të rinjtë mendojnë se shumë më tepër duhet bërë nga ana e politikës dhe institucioneve të qeverisjes qendrore dhe lokale, për të bërë të mundur që ata të kenë edhe shanse të barabarta me bashkëmoshatarët e tyre
- ▲ Ka ende punë për t'u bërë në kuptimin e informimit të të rinjve, për detyrat dhe përfitimet që presin shqiptarët dhe sidomos të rinjtë, nga anëtarësimi i Shqipërisë në BE, dhe në mënyrë të veçantë për shanset dhe horizontet që ky proces do të hapte për ata vetë, sa i përket arsimit dhe karrierës së tyre.

Një shifër e cila rritet disi, kur të rinjtë pyeten për programe konkrete, siç është Erasmus+, për të cilin edhe projekti “Bashkitë për në Evropë” ka zhvilluar seanca informimi në bashkëpunim me Njësitë e Integritimit Evropian në disa prej bashkive të Shqipërisë. Megjithatë, bie në sy një etje e madhe nga ana e të rinjve për të mësuar më shumë mbi programe të ngjashme të BE me fokus rininë.


Të mësipërmet janë shpresat e të rinjve për të ardhmen, ndërkohë që të pyetur për të shkuarën dhe të tashmen, ose më saktë për investimet që Bashkimi Evropian ka bërë në qytetin ku ata jetojnë, del në pah nevoja për më shumë shpërndarje informacioni mbi projektet e shumta dhe investimet në fusha të ndryshme që Bashkimi Evropian ka bërë dhe po bën në Shqipëri, të cilat kanë patur ndikim domethënës në përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe posaçërisht të rinjve. Shtimi i takimeve dhe sesioneve informuese me të rinjtë, diskutimet mbi projektet dhe investimet e BE-së, realizimi i botimeve dhe veçanërisht videove e grafikave informuese mbi këto investime, si dhe shfrytëzimi i mjeteve moderne të komunikimit, shumë të përdorura prej të rinjve, përfshirja e vetë këtyre të rinjve në realizimin e fushatave informuese janë disa prej masave që nevojitet të merren për të shtuar ndërgjegjësimin mbi praninë e BE në qytetet shqiptare me projekte dhe investime konkrete.

E ndërkohë që ka një shpërndarje pothuajse të barabartë mes Infrastrukturës, Shërbimeve Sociale dhe Arsimit, kur pyeten të rinjtë mbi investimet konkrete të Bashkimit Evropian në qytetin e tyre deri më sot, duket se shumica e tyre nuk kanë asnjë dyshim, kur bëhet fjalë për fushën në të cilën do të donin të shihnin më shumë investime dhe projekte nga BE në të ardhmen: ARSIMIN. Një shifër domethënëse e sondazhit, e cila bën të dëgjohet qartë zëri i të rinjve.

Zë i cili, me sa duket, nuk ka forcën e duhur dhe nuk mbërrin si duhet në veshët e duhur, kur vjen fjala tek autoritetet lokale. Shumica e të rinjve, ose nuk e dinë ose pohojnë se bashkia ku jetojnë nuk ka një strategji apo plan veprimi me fokus të rinjtë, ndërkohë që pothuaj 70 përqind e tyre shprehin që edhe nëse ekzistojnë, ata dhe bashkëmoshatarët e tyre nuk ndjehen të përfshirë në hartimin e këtyre politikave.

Padyshim që një prej mënyrave për të bërë të dëgjohet më fort zëri i të rinjve, është ngritja e Këshillave Rinore. Dhe në këtë pikë, të rinjtë që u janë përgjigjur pyetjeve ndahen pothuaj përgjysmë, sa u përket ngritjes së Këshillave Rinore në bashkitë ku jetojnë si dhe aktivizimit të këtyre Këshillave aty ku janë krijuar.

71% - PO
16% - NDOSHTA
6% - JO
8% - NUK JAM I/SIGURT



ANETARËSIMI NË BE SI ASPIRATË

PYETJA 1

A MENDONI SE ANËTARËSIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN DUHET TË MBETET NJË ASPIRATË E PANDRYSHUAR E SHQIPTARËVE? _____

- ▶ Pyetjes në lidhje me vazhdimësinë e aspiratës së shqiptarëve, që Shqipëria të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian, i janë përgjigjur pozitivisht 71 përqind e të rinjve të pyetur, gjë që flet për një mbështetje të madhe mes të rinjve, të aspiratave të Shqipërisë për t'u bërë pjesë e familjes së madhe të BE.
- ▶ 16 % e tyre janë përgjigjur pozitivisht por jo të bindur, ndërkohë vetëm 6 % kanë qenë kundër. 8% e të rinjve të pyetur janë shprehur të pasigurt nëse Shqipëria duhet të këmbëngulë në këtë aspiratë.


VETËDIJËSIMI MBI BASHKIMIN EVROPIAN

PYETJA 2

SA TË INFORMUAR JENI MBI
BASHKIMIN EVROPIAN DHE
FUNKSIONIMIN E TIJ


Sa i përket informimit të të rinjve mbi BE dhe mënyrën se si funksionon Unioni, nga 980 të pyetur, **364 prej tyre ose 37%** janë përgjigjur se janë shumë të informuar.

Bie në sy nevoja për një rritje të informimit të të rinjve mbi mënyrën e funksionimit të BE, teksa **512 prej tyre ose 52%** janë përgjigjur se janë “disi të informuar”. Pak të informuar janë **80 ose 8%** ndërkohë që numri i aspak të informuarve është minimal, **24 të pyetur ose 2 %** e tyre.



RITMI I INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BE

86% - NGADALË
13% - ME RITMIN E DUHUR
1% - NUK E DI



PYETJA 3

SI MENDONI SE PO ECËN PROCESI
I INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË
BASHKIMIN EVROPIAN? _____

Pjesa dërmuese e të rinjve, **86 % e tyre ose 816** nga 980 të pyetur, duket se janë të pakënaqur me ritmet e integrimit të Shqipërisë në BE, teksa shprehen se ky proces po ecën ngadalë. Eshhtë e qartë dëshira dhe vullneti i tyre për një marsh më shumë sa i përket rrugëtimit të Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

124 nga të rinjtë e pyetur, ose 13% mendojnë që procesi po ecën me ritmin e duhur ndërkohë që **1 %** janë përgjigjur “nuk e di”.

FAKTORËT QË NDIKOJNË PROCESIN E INTEGRIMIT

PYETJA 4


KUSH MENDONI SE JANË FAKTORËT
QË NDIKOJNË NË PROCESIN E
INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BE

736 nga 984 të rinjtë e pyetur, ose 74 % e tyre identifikojnë politikën si faktorin parësor me ndikim në ritmet e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

13 % e tyre, ose 132 nga 984 të rinj që janë përgjigjur, mendojnë se është vetë Bashkimi Evropian dhe strukturat e tij faktori më me ndikim në këtë proces.

Për 72 të rinj që janë përgjigjur, ose 7% e tyre janë vetë qytetarët që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e integrimit.

4 % janë përgjigjur “nuk e di” ndërkohë që vetëm 1 % i shohin institucionet lokale si faktorë me ndikim në këtë proces.



ANËTARËSIMI NË BE DHE MUNDËSITË PËR ARSIMIM


PYETJA 5

A MENDONI SE ANËTARËSIMI I SHQIPËRISË NË BE DO TË RRISE NDJESHËM MUNDËSITË TUAJA PËR SHKOLLIM DHE PUNËSIM?

Po si i shohin të rinjtë, mundësitë që do të ofronte për shkollimin e tyre, anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian?

808 nga 984 të rinj që u janë përgjigjur pyetjeve (82%), shprehen që “absolutisht po”, anëtarësimi i Shqipërisë do të sjellë mundësi të mira për arsimimin e tyre.

Vetëm **4 % ose 44** të rinj janë përgjigjur negativisht, **116 prej tyre ose 12%** janë shprehur të pavendosur dhe **2 %** janë përgjigjur që nuk e dinë se si do të ndikonte një gjë e tillë për karrierën dhe të ardhmen.



INVESTIMET E BE NË QYTETIN TIM


PYETJA 6

A JENI TË INFORMUAR PËR INVESTIMET QË BE KA BËRË NË QYTETIN TUAJ? _____


Po sa janë të informuar të rinjtë, në lidhje me investimet që Bashkimi Evropian ka bërë në qytetin e tyre?

Nga 980 të rinj që u janë përgjigjur pyetjeve, **240 prej tyre ose 24%** shprehen se janë të mirëinformuar mbi investimet e BE në qytetin ku jetojnë. **40% e tyre, ose 388** shprehen se janë deri diku të informuar, por jo plotësisht.

I konsiderueshëm është numri i të rinjve që shprehen se janë të painformuar, rreth **31% ose 300** e atyre që u janë përgjigjur pyetjeve, ndërsa **5% ose 52** të rinj shprehen “nuk e di”.



NDIKIMI I MBËSHTETJES SË BASHKIMIT EVROPIAN



29 % - PO

57 % - JO

15 % - NUK JAM I/E SIGURT

PYETJA 7

A E KENI NDJERË JU DHE FAMILJA JUAJ NDIKIMIN E MBËSHTETJES QË BE KA DHËNË PËR BASHKINË/QYTETIN TUAJ? _____

284 prej të rinjve që janë pyetur, ose **29%** e tyre janë përgjigjur se e kanë ndjerë ndikimin e mbështetjes që Bashkimi Evropian ka dhënë për qytetin/bashkinë ku banojnë.

556 ose **57%** shprehen që nuk e kanë ndjerë këtë ndikim dhe **15%**, ose **144** prej të pyeturve shprehen që nuk janë të sigurt.

Këtu duhet patur parasysh që pyetësi ka patur një shtrirje në të gjithë qytetet e Shqipërisë, dhe në të janë përgjigjur edhe të rinj, nga qytete në të cilët ende nuk ka projekte të BE të zbatuara apo në zbatim.

FUSHAT E MBËSHTETJES SË BASHKIMIT EVROPIAN


PYETJA 8

NË CILËN FUSHË ËSHTË NDJERË
MË SHUMË MBËSHTETJA E BE
NË QYTETIN TUAJ? _____

Infrastruktura është fusha ku, sipas të rinjve të pyetur, është ndjerë më shumë dora e mbështetjes së BE në qytetin ku banojnë. **280 ose 26%** e tyre kanë zgjedhur këtë fushë, ndërsa **17% ose 160** prej të pyeturve kanë zgjedhur shërbimet sociale.

104 nga 944 të rinjtë e pyetur (11%) kanë zgjedhur Mjedisin, **92 prej tyre ose 10%** kanë zgjedhur Arsimin dhe 64 Kulturën (7%).

Një numër domethënës, **30%** e të pyeturve ose **280** të rinj kanë zgjedhur zërin “të tjera”.



26 % - INFRASTRUKTURA
17 % - SHERBIME SOCIALE
11% - MJEDISI
10% - ARSIMI
7% - KULTURA
30% - TE TJERA

KU MUND TË BËJË MË SHUMË BASHKIMI EVROPIAN?


PYETJA 9

NË CILËN FUSHË MENDONI SE
BE MUND TË BËJË MË SHUMË NË
QYTETIN TUAJ?

Përballë pyetjes se në cilën fushë BE mund të ndihmojë më shumë, të rinjtë nuk kanë asnjë dyshim: ata zgjedhin Arsimin si fushën më të rëndësishme. Nga **984** të pyetur, **292** prej tyre ose **30%** zgjedhin Arsimin ndërsa **280** ose **28%** zgjedhin Infrastrukturën.

24% e të rinjve, ose **240** kërkojnë të bëhet më shumë për Shërbimet Sociale, ndërsa respektivisht **60** dhe **52** prej tyre ose **6** dhe **5%** kërkojnë të bëhet më shumë për Mjedisin dhe Kulturën.

6% e të rinjve (**60**) kanë zgjedhur zërin të tjera.




30 % - ARSIMI
28 % - INFRASTRUKTURA
24% - SHERBIME SOCIALE
6% - MJEDISI
5% - KULTURA
6% - TE TJERA

INFORMIMI I TE RINJVE MBI BASHKIMIN EVROPIAN



PYETJA 10

A JENI TË INFORMUAR MBI
MUNDËSITË QË BASHKIMI
EVROPIAN OFRON PËR TË RINJTË? _____



37 % - PO
48 % - DERI DIKU
15 % - JO


Vetëm **37%** e **972** të rinjve që u janë përgjigjur pyetjeve, ose **360** prej tyre shprehen se janë të informuar mbi mundësitë që BE ofron për ata dhe bashkëmoshatarët e tyre.

48%, pothuajse gjysma e të pyeturve ose **468** shprehen se janë deri diku të informuar, ndërsa **15%** e të pyeturve, ose **144** shprehen se nuk janë të informuar mbi mundësitë që BE ofron për ta.

INFORMIMI I TE RINJVE MBI ERASMUS+

PYETJA 11

A JENI TË INFORMUAR MBI PROGRAMIN ERASMUS+ DHE MUNDËSITË QË OFRON PËR TË RINJTË?



42 % - PO

28 % - DERI DIKU

30 % - JO

Sa i përket një programi konkret për të rinjtë, si Erasmus+ dhe mundësitë që ai ofron për ta, nga **976** të rinj që u janë përgjigjur pyetjeve, **408 ose 42%** e tyre shprehen se janë të informuar.

276 prej tyre ose **28%** shprehen se janë deri diku të informuar ndërsa **30** përqind e të rinjve që u janë përgjigjur pyetjeve, ose **30** përqind e tyre shprehen se nuk kanë informacin mbi mundësitë që ky program ofron për ta.


PROGRAMET E VULLNETARIZMIT TE BE PËR TË RINJTË

PYETJA 12

A JENI TË INFORMUAR QË BASHKIMI
EVROPIAN KA PROGRAME SPECIFIKE TË
VULLNETARIZMIT PËR TË RINJTË? _____

Nga **984** të rinj që i janë përgjigjur pyetjes, nëse janë të informuar mbi programe specifike të vullnetarizmit që BE ka për Shqipërinë, **428** prej tyre ose **43%** shprehen se e kanë informacionin për këto programe.

336 prej të rinjve që janë përgjigjur, ose **34%** shprehen se janë deri diku por jo plotësisht të informuar ndërkohë që **22%** e të rinjve ose **220** prej tyre shprehen se nuk kanë informacion në lidhje me këto programe specifike.



43 % - PO
34 % - DERI DIKU
22 % - JO


A KA STRATEGJI BASHKIA PËR TË RINJTË

PYETJA 13

A KA BASHKIA KU JETONI NJË
STRATEGJI APO PLAN VEPRIMI
NË MBËSHTETJE TË TË RINJVE?


Nga **984** të rinj që i janë përgjigjur pyetjes, nëse Bashkia ku ata jetojnë e ka një strategji apo plan veprimi në mbështetje të tyre dhe bashkëmoshatarëve të tyre, **340** prej tyre ose **35%** shprehen që po, bashkia e ka një strategji apo plan të tillë.

276 nga **984** e atyre që janë përgjigjur, ose **28%** shprehen që bashkia ku jetojnë nuk e ka një plan të tillë ndërkohë që **368**, apo **37%** janë të painformuar mbi ekzistencën ose jo të një strategjie apo plani nga ana e autoritetit të pushtetit lokal në qytetin ku jetojnë.



35 % - PO
28 % - JO
37 % - NUK E DI

PËRFSHIRJA NË PLANET E BASHKISË



31 % - PO

69 % - JO

PYETJA 14

NËSE PO, A JENI NDJERË TË
PËRFSHIRË NË HARTIMIN E NJË
STRATEGJIE/PLANI TË TILLË?

Shumë domethënës rezultati i përgjigjeve të pyetjes mbi përfshirjen e të rinjve në strategjitë/planet e bashkisë për ta.

Një shumicë e tyre, **672** nga **984** që janë përgjigjur, ose **69%** e të rinjve shprehen se nuk janë të përfshirë në strategjitë/planet e bashkisë ku jetojnë, për ta.

Vetëm **31%** e të pyeturve janë shprehur që janë të përfshirë.


KËSHILLI RINOR NË BASHKI

PYETJA 15

A ËSHTË NGRITUR KËSHILLI
RINOR NË BASHKINË TUAJ?

Nga **980** të rinj që janë përgjigjur, **43%** e tyre janë të informuar mbi ngritjen e Këshillit Rinor në Bashkinë ku jetojnë.

26% e tyre ose 252 nga **980** shprehen se Këshilli Rinor nuk është ngritur ndërsa **31%** e të rinjve, ose **31%** shprehen se në bashkinë e qytetit ku jetojnë nuk është ngritur një strukturë e tillë.



43 % - PO

26 % - JO

31 % - NUK E DI

SA AKTIV ËSHTË KËSHILLI RINOR?

PYETJA 16


SA AKTIV ËSHTË KËSHILLI RINOR NË
DISKUTIMIN E PROBLEMEVE TË TË
RINJVE ME VENDIM-MARRËSIT? _____

924 të rinj i janë përgjigjur kësaj pyetjeje.

Në pyetjen mbi trajtimin e problemeve që lidhen me rininë nga ana e Këshillit Rinor, në përballje me vendim-marrësit në bashki, bie në sy që një pjesë e madhe e të rinjve, **38%** nuk janë fare të informuar mbi këtë gjë.

25% e tyre ose **228** nga **924** të pyetur shprehen se Këshilli Rinor është shumë aktiv.

Ndërkohë nga **19%** shprehen respektivisht që është pak aktiv, ose aspak aktiv.



25 % - SHUMË AKTIV

19 % - PAK AKTIV

19 % - ASPAK


38 % - NUK E DI

MESAZHET E TË RINJVE

Cilat do të ishin disa nga sugjerimet tuaja për një përfshirje më të madhe tuajën dhe bashkëmoshatarëve tuaj, në procesin e vendim-marrjes në bashkinë tuaj? _____

Pjesë e pyetësorit ka qenë dhe një hapësirë, ku të rinjtë mund të linin mesazhet e tyre mbi pritshmëritë që kanë sa i përket procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Ja cilat ishin disa prej mesazheve të tyre.



Te krijohet nje mbledhje keshilli si keto te bashkive me te rinjte qyteteve dhe me nje kryetare te zgjedhur po nga ky keshill

Nga moshë 10 vjeq e lart duhen pare e studjuar sepse .po marrin rruge te gabuaraa . Qe qojne ne vjedhje dhe zenka .konsumimin e lendeve te pa ligjshme .prinderit po i dergojne ne shkolla .por nuk futen ne mesim . Duhet te hapni qendra sportive kulturore . Pas orarit te mesimit qe te ken mundesi te merren me nje aktivitet se sa rrin rruges . Ju faleminderit

Ngritje forumesh rinore, fuqizim forumesh rinore, mbeshtetje me programe te dedikuara

Une do te doja qe bashkia te informonte qytetaret dhe, sidomos rinine me risite dhe investimet qe Bashkimi European po ben ne qytetin tim. une si qytetare e bashkise nuk kam asnje informacion rreth veprimtarise se BE ne qytetin tim.

MESAZHET E TË RINJVE

-Veprimtari me praktike dhe efektive per te rinjte ne fusha qe atyre ju nevojiten

Bashkepunimi i bashkise me te rinjte dhe informimi i tyre ne takime te posacme rreth interesave dhe problematikave tona.

Te krijohej nje keshill rinor Te reinjte te ishin me pjesmarres , me aktive ne programet dhe organizimet qe ben bashkia. Te ofroheshin me shume mundesi praktikash pe rte rinjte ne profesionin e tyre por dhe me tej qe te ishin pjesmarres ne vendim-marrje ne bashkine e qytetit tone .

Te kete me shume investime dhe projekte qe te perfshije te rinjte. Te punojme per nje jete me te mire.

Zakonisht aktivitetet sportive apo konkurset arsimore jane ato qe na kanë bërë të jemi të përfshirë, por gjithashtu një sugjerim mund të jetë bashkimi dhe solidarizimi më i tepërt i ne të rrinjve për të ndihmuar familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara si dhe dashamirësia për artin.

Mendoj qe rinia duhet te jete pjese shume e rendesishme ne vendi marrjen e vendimeve te bashkise . Jo anetaret e keshillit qe jane te gjithë partiak dhe marrin vendime sipas interesit personal dhe jo komunitar . Mendimi im nuk degjohet askund sepse bashkia ska nje program ku une te jap mendimin tim , iden qe kam per ceshtje te caktuar . Akoma me teper kur jam pjese aktive ne shume gjera ne bashkin ku jam . BE jep fonde pa i bere publike bashkia se ku jane dhe as ka transparence fare , zero . Kam shume ide per bashkin ku jetoj por skam asnje fond qe te ushtroj minimumin e ideve per arsimin , kulturen , ambientin .

Cilat do të ishin disa nga sugjerimet tuaja për një përfshirje më të madhe tuajën dhe bashkëmoshatarëve tuaj, në procesin e vendim-marrjes në bashkinë tuaj? _____

Pjesë e pyetësorit ka qenë dhe një hapësirë, ku të rinjtë mund të linin mesazhet e tyre mbi pritshmëritë që kanë sa i përket procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Ja cilat ishin disa prej mesazheve të tyre.

SHQIPËRIA & BE

ÇFARË DUHET TË PRESIN TË RINJTË?

Ky botim u realizua nga Projekti “Bashkitë për në Evropë”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.
Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian